



SH.LUJ "UNIVERSITETI
MARIN BARLETI"

Nr. 2569 Prot.

Tiranë, më. 11/4/2019

Nr. 132 Prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS SHLUJ "UNIVERSITETI MARIN BARLETI" DHE KLINIKË RUSI

NENI 1

QËLLIMI DHE OBJEKTI

1. Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e bashkëpunimit mes SHLUJ "Universiteti Marin Barleti" dhe Klinikës RUSI
2. Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi dhe realizimi i praktikave mësimore të studentëve të SHLUJ Marin Barleti dhe Klinikës RUSI

NENI 2

KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e firmosjes nga përfaqësuesit e të dyjave palëve dhe mbetet në fuqi për 3 vjet nga data e firmosjes
2. Me përfundimin e afatit, nëse asnjëra palë nuk shpreh vullnetin për ti dhënë fund, kjo marrëveshje rinovohet për një afat tjetër 3 vjeçar.

NENI 3

INFORMACION PËR PALËT

1. Të dyja palët bien dakord të bashkëpunojnë në frymën e një mirëkuptimi reciprok si dhe me vullnetin pozitiv për të siguruar kushtet e nevojshme për realizimin e plotë dhe cilësor të praktikës mësimore të studentëve të Institucionit Jo Publik SHLUJ "Universiteti Marin Barleti".
2. Palët bien dakord të shkëmbejnë eksperiencë dhe të shfrytëzojnë kapacitetet e përbashkëta njerëzore dhe teknike nëpërmjet projekteve të përbashkëta.
3. Praktika do të zhvillohet pranë institucionit Klinikës RUSI, Tiranë, për studentët që ndjekin Programet e Studimit me karakter profesional në:

" Operator dhe këshillues në Përkujdesje Shëndetësore"





SH.LUJ "UNIVERSITETI
MARIN BARLETI"

Praktika do të drejtohet nga pedagogu SHLUJ "Universiteti Marin Barleti" Perli Rusi, në Tiranë ku studentët do të kryejnë praktikën mësimore.

Për periudhën e praktikës studentët janë të detyruar ndaj rregullave të Institucionit ku kryejnë praktikën.

NENI 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

SHLUJ "Universiteti Marin Barleti" merr përsipër:

1. Të prezantojë paraprakisht numrin e studentëve dhe listën e plotë të tyre që do të kryejnë praktikën
2. Të paraqesë programin e praktikës të cilin do të zhvillojnë studentët.
3. Të respektojë rregullat e parashikuara në rregulloret e brendshme si dhe legjislacionin në fuqi me anë të të cilit bëhet rregullimi i funksioneve të brendshme shëndetësore, përfshi respektimin e orareve të përcaktuara.

Klinika RUSI merr përsipër:

1. Pranimin e studentëve për kryerjen e praktikës sipas programit të parashikuar.
2. Ofrimin e kushteve të nevojshme për kryerjen e praktikës dhe mbikqyrjen e ecurisë së praktikës me qëllim përfitimin e kualifikimit sa më cilësor.
3. Vënien në dispozicion të mjediseve të Institucionit për kryerjen e praktikës duke përfshirë edhe kapacitetet teknike si laboratorët, pajisjet etj.
4. Përgatitjen e një karakteristike për çdo student në përfundim të praktikës duke përshkruar nivelin e përvetësimit gjatë praktikës.

NENI 5

DISPOZITAT E FUNDIT

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve firmëtare, të shprehur në një dokument të shkruar

Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej palëve, çon detyrimisht në prishjen e saj. Vullneti për mbarimin e marrëveshjes para afatit, komunikohet me shkrim nga partneri, duke argumentuar arsyjet e këtij veprimi.



SHLUJ "Universiteti Marin Barleti"



KLINIKA RUSI

INSTRUKTORI

DORIDA FISHA
TRAUMA FSH
NR 089294709



Rusi
van der